



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 614/8 prot.

Tiranë, më 16. 12.20 22

VENDIM

Nr. 932 Datë 16. 12. 2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË ILS SP Z.O.O. DHE DANX GROUP A/S ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16. 12. 2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë ILS sp z.o.o. dhe Danx Group A/S.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë ILS sp z.o.o. dhe Danx Group A/S.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë ILS sp z.o.o. dhe Danx Group A/S.

Referuar dokumentit “Marrëveshje sipërmarrje e përbashkët dhe ortakërie”, palët janë:

Pala 1: ILS sp. z.o.o., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjet e Republikës së Polonisë. ILS sp. z.o.o. është një shoqëri logjistike, që ofron shërbime dhe zgjidhje të dedikuara në lidhje me magazinimin e mallrave dhe transportin vendas dhe ndërkombëtar. ILS sp. z.o.o. ka eksperiencë të gjerë në ofrimin e shërbimeve për industrinë automotivë, kimike dhe petrokimike, si dhe sektorin FMCG (produkte të cilat shiten shpejt).

ILS sp. z.o.o. kontrollohet nga shoqëria Inter Cars S.A., shoqëri aksionare, e themeluar dhe ekzistuese në përputhje me ligjet e Republikës së Polonisë, e cila është pjesë e Grupit Inter Cars, biznesi kryesor i të cilit është shitja e pjesëve të këmbimit të automobilave për makina pasagjerësh dhe tregtare.

ILS, Inter Cars ose ndonjë prej filialeve të tyre nuk zotëron ndonjë degë apo filial në Shqipëri, por nëpërmjet shoqërisë Inter Cars, deklarojnë të ardhura nga shitja e produkteve nga të tretë.

Pala 2: Danx Group A/S është një shoqëri me ofertë publike me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjet e Danimarkës. Objekti i shoqërisë është zotërimi i aksioneve të kapitalit në shoqëri të tjera, duke përfshirë shoqëritë që operojnë me tregti, industri, import, eksport dhe qira, si dhe biznese të tjera të lidhura me to.

Danx Group A/S kontrollohet nga AX VI INV5 Holding III ApS, shoqëri aksionare, shoqëri portofol (ku zotërojnë interesa) e Axcel VI, pjesë e Axcel, i cili është një fond kapitali privat me fokus të veçantë në ndërmarrjet e mesme në vendet Nordike. Axcel VI, bashkë me fondet e tjera Axcel përbën një grup shoqërisht të ndryshme, aktive kryesisht në Zonën Ekonomike Evropiane.

DANX dhe Axcel ose ndonjë prej filialeve të tyre direkt ose indirekt nuk kanë asnjë prani dhe nuk janë aktive në tregjet përkatëse në Shqipëri, por nëpërmjet shoqërisë Axcel V, deklarojnë të ardhura nga shitja e produkteve nga të tretë.

Ndërmarrja e Përbashkët (JV), do të jetë një shoqëri e re me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të operojë me emrin e biznesit Danxils sp. z.o.o. dhe do të jetë fillimisht aktive në tregun e logjistikës në territorin e Polonisë, duke ofruar veçanërisht shërbime si: shpërndarje brenda natës; PUDO (stacion “marrje, dorëzime”); FSL-s (vendndodhje magazinim-depo magazinimi); magazinim.

Danxils sp. z.o.o. nuk pritet që në një fazë fillestare të jetë e pranishme në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Më datë 14 shtator 2022 është nënshkruar “Marrëveshje e sipërmarrjes së përbashkët dhe ortakërisë” nga shoqëritë ILS sp. z.o.o. dhe Danx Group A/S.

Referuar kësaj marrëveshjeje, shoqëritë ILS sp. z.o.o. dhe Danx Group A/S do të japin një kontribut të barabartë për investimin fillestar të Shoqërisë së Re, ku secila prej këtyre shoqërive do të zotërojë 50% të kapitalit të Shoqërisë së Re dhe të drejtën për 50% të numrit të përgjithshëm të votave në Mbledhjet e Ortakëve.

Ndërmarrja e përbashkët-JV do të kryejë, në një bazë afatgjatë, të gjitha funksionet e një entiteti ekonomik autonom, pasi do të jetë aktiv në tregun e logjistikës në territorin e Republikës së Polonisë dhe do të ofrojë në veçanti shërbimet si: (i) shpërndarja brenda natës; (ii) zgjidhjet PUDO (marrje dhe dorëzime), (iii) FSL (vendndodhje magazinimi – depo magazinimi); (iv) magazinimin.

Referuar marrëveshjes së krijimit të një ndërmarrjes së përbashkët me funksione të plota (JV), si dhe pasqyrave financiare të palëve, transaksioni i propozuar, përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i logjistikës dhe transportit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët Joint-Venture me funksione të plota nga shoqëria ILS sp z.o.o. dhe shoqëria DANX Group A/S, e cila do të krijohet në Poloni dhe nuk ka plane që ajo të jetë aktive në Shqipëri.

Përqendrimi i njoftuar nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar

PËR KËTO ARSYE:




Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë ILS sp z.o.o. dhe shoqëria DANX Group A/S.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Leida MATJA  Zv/Kryetar	Rezana KONOMI  Anëtar	Adriana BERBERI  Anëtar	Durim KRAJA  Anëtar
---	---	--	---


Kryetar